

## Editorial

### I dashur lexues,

Jemi shumë të kënaqur të hapim numrin e parë të Buletinit të programit PRO NEWS, i cili do t'ju informojë rregullisht mbi aktivitetet dhe ngjarjet kryesore të realizuara përgjatë kohës së zbatimit të Programit.

Siç mund ta dini tashmë, Programi PRO NEWS filloi rrugëtimin e tij në janar 2017, nën zbatimin e partnerëve të konsorciumit në bashkëpunim me institucionet kryesore shqiptare të koordinuara nga Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, të cilët po punojnë në sinergji për të përcaktuar një plan aktivitetesh të përshtatura sa më shumë me nevojat e përfituesve.

PRO NEWS ka hyrë në fazën e zbatimit me një sërë aktivitetesh të fokusuara në planifikimin e emergjencave, hartëzimin e riskut dhe parandalimin e rrezikut nga përmbytjet.

Ne të gjithë e dimë se përmbytjet paraqesin një kërcënim të konsiderueshëm për çdo vend. Shqipëria u godit rëndë nga përmbytjet në vitin 2015, duke shkaktuar dëmtime të mëdha në të gjithë vendin.



Programi për përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe parandalimin e përmbytjeve në Shqipëri

Në këtë drejtim, PRO NEWS është projektuar për të arritur qëllimin final të rritjes së aftësive ripërtëritëse ndaj përmbytjeve, të cilat mbartin gjithmonë pasoja në aspektin e humbjeve njerëzore, ekonomike dhe financiare. Për të siguruar këtë, ne besojmë se masat gjithëpërfshirëse që mbulojnë aspekte të ndryshme të parandalimit, të reagimit dhe të gatishmërisë duhet të trajtohen të gjitha së bashku dhe kjo është arsyeja pse PRO NEWS përfshin pesë komponentë të ndërlidhur pune.

Lexim të këndshëm!

### Në këtë numër:

**Duke punuar për zbatimin e Programit...**



**Takimi i dytë i Komitetit Drejtues të Programit PRO NEWS**







## Duke punuar për zbatimin e Programit ...

Pas çeljes së programit PRO NEWS më 15 janar 2017, në periudhën e parë të zbatimit të tij, shkurt - prill 2017, ekipi i konsorciumit zhvilloi një sërë vizitash dhe takime pune në Tiranë për t'u njohur me përfituesit e Programit, për të vendosur partneritetin e nevojshëm dhe për të paraqitur kuadrin e punës së programit.

Misionet u koordinuan nga Ministria e Brendshme (MB) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (DPEC), për të siguruar që të gjitha palët e përfshira në proces të bëheshin pjesë e diskutimeve përkatëse. Konsorciumi u përfaqësua me ekspertë nga secila organizatë partnere dhe ekipi drejtues i programit, ndërsa nga institucionet përfituese merrnin pjesë ekspertë teknikë të fushës.

Takimet e para, të organizuara në përputhje me secilin komponent të Programit, u zhvilluan përgjatë muajit mars.



Një nga çështjet më të diskutuara kishte të bënte me bashkëpunimin me palët përfituese. Prandaj dhe përpjekjet kryesore në këtë fazë të parë të punës u përqëndruan në forcimin e partneritetit me të gjitha palët përfituese; në përcaktimin e rolit të MB-së dhe DPEC-së si përfituesit kryesorë të Programit dhe funksionit të tyre si koordinatorë me institucionet e tjera shqiptare; në vendosjen e bashkëpunimit me Institutin e Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit si përfitues kryesor nga komponentja D e programit. Në mbyllje të kësaj faze u arrit vendosja e partneritetit me përfituesit, duke përcaktuar rrjedhën e komunikimit ndërmjet Palëve Përfituese dhe Partnerëve të Konsorciumit dhe finalizimi i planit të punës për programin PRO-NEWS, duke synuar aktivitete në përputhje me nevojat e partnerëve përfitues dhe me propozimin e miratuar të programit. Miratimi i planit të punës nga të gjithë përfituesit më 25 maj 2017 shënon fillimin e zbatimit të aktiviteteve të Programit PRO NEWS.



## Takimi i dytë i Komitetit Drejtues të Programit PRO NEWS

*Programi hyn në fazën e zbatimit të aktiviteteve*

Programi për Përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe parandalimin e përmytjeve në Shqipëri (PRO NEWS) zhvilloi takim të dytë të Komitetit Drejtues, më 14 korrik 2017. Ky takim shënoi fillimin e fazës së zbatimit të Programit, në përputhje me planin e punës të miratuar gjatë fazës përgatitore të programit.

Takimi, i organizuar nën kujdesin e Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC), mbledhi së bashku përfaqësues të institucioneve kryesore në nivel kombëtar të përfshirë në sektor, si Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, Sekretariati Teknik i Këshillit të Ujërave, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeo-Hapësinor, nga autoritetet përgjegjëse për parandalimin e përmytjeve në vend, nga organizatat ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë, si dhe partnerët e Konsorciumit.

Partnerët e konsorciumit të Programit PRO NEWS paraqitën raportin përgatitor të Programit, përmes një plani të detajuar të punës për gjashtë muajt e ardhshëm.

Komponentët e Programit u prezantuan një nga një, duke u fokusuar në hapat kryesorë për të filluar punën konkrete.



Mjeti për vlerësimin e planeve për emergjencat, i hartuar bashkërisht nga CIMA dhe DPC, është hapi i parë për të bërë vlerësimin e dokumentacionit ekzistues në nivel prefektural, kjo në kuadër të komponentit B të programit "Përmirësimi i Kuadrit Ligjor dhe Institucional lidhur me Paralajmërimin e Hershëm, Menaxhimin e Përmytjeve, Mbrojtjen Civile dhe Planifikimin për Emergjencat".

Në kuadër të komponentit E "Promovimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të nxitjes tek popullata e sjelljes së duhur në rast emergjence", po punohet për përgatitjen e pyetësorëve dhe të intervistave me aktorët kryesorë në vend, me qëllimin për të vlerësuar nivelin e ndërgjegjësimit publik dhe për të hartuar fushatën kombëtare të

ndërgjegjësimit publik.

Prezantimi i fundit në takim ishte në kuadër të komponentit F të programit "Ndihmesë për institucionet shqiptare për t'u përfshirë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian". Konsorciumi paraqiti planin e aktiviteteve për këtë komponent deri në maj 2018.

Të gjithë pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e miratimit të planit të punës të programit PRO NEWS, në pritje të aktiviteteve konkrete përgjatë zbatimit të programit.



## Takim teknik për përmirësimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe menaxhimit të përmbytjeve në Shqipëri

Në kuadër të komponentit D të Programit "Përmirësimi i Paralajmërimit të Hershëm të Përmbytjeve dhe përfshirja në Sistemin Evropian të Ndërgjegjësimit të Përmbytjeve", u zhvillua më 12-13 korrik 2017, takimi teknik me përfaqësues të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) në Shqipëri.

Ekspertët e Programit PRO NEWS diskutuan gjerësisht me stafin e IGJEUM mbi komponentin teknik të programit përsa i takon përmirësimin të sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe menaxhimit të përmbytjeve në Shqipëri. Ekspertët e konsorciumit vizituan gjithashtu sallën operative ku përgatiten buletinet meteorologjike dhe monitorohen ngjarjet e motit.

## Rritja e ndërgjegjësimit dhe e aftësive ripërtëritëse të publikut lidhur me paralajmërimin e hershëm

Në kuadër të komponentit E të programit "Promovimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të nxitjes tek popullata e sjelljes së duhur në rast emergjence", po punohet për përgatitjen e pyetësorëve dhe të intervistave me aktorët kryesorë në vend.

Përmes pyetësorëve, synohet të vlerësohet niveli i njohurive të publikut lidhur me sistemin e paralajmërimit të hershëm dhe të rrezikut nga fatkeqësitë; të kuptohet më mirë se si njerëzit e perceptojnë rrezikun në rast katastrofash dhe të identifikohen burimet kryesore të informacionit lidhur me sistemin e paralajmërimit dhe të rrezikut nga fatkeqësitë në Shqipëri.

Pyetësorët janë të përshtatur sipas grupeve të audiencës së synuar - për publikun e gjerë, për biznesin privat, për mësuesit dhe për nxënësit. Në përfundim të kësaj faze, do të mund të arrihet mbledhja e mesazheve kyç të rëndësishme për audiencën dhe identifikimi i qasjes së duhur për ndërgjegjësimin publik në komunitetet e prekura dhe për paralajmërimin e hershëm në rast emergjence.

## Workshop kombëtar: Një hap më tej në Planifikimin për Emergjencat

Programi PRO NEWS zhvilloi në datat 5-6 tetor 2017 workshopin kombëtar "Një hap më tej në Planifikimin për Emergjencat", me pjesëmarrjen e 12 Prefekturave të Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile dhe aktorë të tjerë në nivel kombëtar.

Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i mendimeve dhe rritja e njohurive lidhur me praktikën e mira në planifikimin e emergjencave, dhe finalizimi i vlerësimit të planeve ekzistuese të emergjencave në nivel prefekturë, përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse.

Partnerët e konsorciumit të programit prezantuan praktikën e mira të ndërmarra nga autoritetet italiane në planifikimin e emergjencave; metodologjinë e vlerësimit për planifikimin e emergjencave dhe rezultatet paraprake të vlerësimit të planeve të emergjencave për prefekturat pilot. Dita e dytë e workshopit u organizua në grupe pune për të rishikuar dhe finalizuar vlerësimin e të gjitha planeve të emergjencave në nivel prefekturë.

Ky workshop kontribuon në qëllimin e përgjithshëm të Përmirësimin të Kuadrit Ligjor dhe Institucional lidhur me Paralajmërimin e Hershëm, Menaxhimin e Përmbytjeve, Mbrojtjen Civile dhe Planifikimin për Emergjencat, komponenti B i programit PRO NEWS.

### Follow the programme on:

 [www.pronewsprogramme.eu](http://www.pronewsprogramme.eu)

 [www.facebook.com/ProNewsAlbania](https://www.facebook.com/ProNewsAlbania)

 [twitter.com/PronewsAlbania](https://twitter.com/PronewsAlbania)

